



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DËRRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 42, datë 29.05.2020

PËR

MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT, ME VENDNDODHJE NË KATIN ZERO TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 602 M² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 578 M² DHE SIP. FUNKSIONALE 24 M²), PRONË E BASHKISË DËRRËS, PËR NJË AFAT 10 (DHJETË) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së Nr.536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Për Qiranë” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin për dhënie me qira të ambjentit, me vendndodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 602 m² (nga kjo sipërfaqe ndërtimi 578 m² dhe sipërfaqe funksionale 24 m²), pronë e Bashkisë Durrës, për një afat 10 vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.



2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Ligjore, Sektori i Pronave Publike Dhe Menaxhimit Të Aseteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.05.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 488/prot.
2

Durrës, më 03.06.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS ✓

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.42 datë 29.05.2020 “Për miratimin e dhënies me qira të ambjentit, me vendndodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, zk 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 602 m² (nga kjo sip. ndërtimi 578 m² dhe sip. funksionale 24 m²), pronë e bashkisë Durrës, për një afat 10 (dhjetë) vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

